

Ekskluzive

# Ekskluzive | Përleshje mes kushërinjve për pronën në Skenderaj – Policia sekuestron armë, tre të dyshuar në pranga



Sinjali.com

07 Gusht 2026 10:26



**Një mosmarrëveshje për pronën në fshatin Klinë e Poshtme të Skenderajt ka përfunduar me përleshje fizike, arrestimin e tre personave dhe sekuestrimin e një arme zjarri.**

Sinjali mëson se të dyshuar janë **Skender Ibishaj**, 61 vjeçar, **Enver Ibishaj**, 61 vjeçar dhe **Arifi Ibishaj**, 57 vjeçar, ndërsa ankues është **Ali Ibishi**, 31 vjeçar.

Sipas burimeve, Policia është njoftuar përmes telefonit për një përleshje mes disa personave. Me të mbërritur në vendin e ngjarjes, zyrtarët policorë kanë takuar ankuesin, i cili ka deklaruar se ishte sulmuar fizikisht nga dy djemtë e axhës së tij, për shkak të një kontesti pronësor, për të cilin të dyja palët pretendojnë pronësinë.

Gjatë kontrollit të një automjeti që ndodhej pranë vendit të ngjarjes, Policia ka gjetur dhe sekuestruar një pistoletë “Sarsilmaz”, kalibër 9×19 mm, së bashku me një karikator dhe 17 fishekë. Sipas hetimeve fillestare, arma nuk dyshohet të jetë përdorur gjatë incidentit.

Të gjitha palët janë shoqëruar në Stacionin Policor në Skenderaj, ku janë intervistuar në prani të procedurave ligjore.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ndaj të dyshuarve është iniciuar procedurë për tri vepra penale: “Sulm”, “Lëndim i lehtë trupor” dhe “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të rastit janë në vazhdim.

**Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.**

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

***/GazetaSinjali/***

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



## Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

## Aktualitet

Politikë  
Drejtësi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

## Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

## Ekonomi

Prodhime Vendore  
Financa  
Biznes

## Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

## Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

## OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

## Jetë

Fitnes  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

## Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

## Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

## Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera